


Projekti Rajonal i Beverly për Besueshmërinë e Transmetimit

Informacione për kërkesën



Gjatë procesit të ndërtimit, McCourt Construction, kontraktor i Rrjetit Kombëtar, ka si detyrim të mbajë një proces të detajuar për të trajtuar kërkesat për dëme ndaj personave, automjeteve ose pronës.

Për të depozituar një kërkesë, ju duhet të:

- Kontaktoni zyrën e McCourt në numrin 617.260.2330
 - Gjithashtu, ju mund të kontaktoni Menaxherin e Sigurisë Joshua Palen me telefon në numrin 617.719.8679 ose me email në adresën jpalen@mccourtconstruction.com.
- Jepni informacionin e mëposhtëm:
 - Data dhe ora e dëmit.
 - Përshkrimi i dëmit dhe vendi.
 - Fotografi dhe dokumente të tjera për të mbështetur kërkesën, d.m.th., raporti i policisë, vlerësimet, shkaku i kërkesës.

Më pas, McCourt do t'ju kontaktojë dhe do të hapë një hetim. McCourt do të shqyrtojë të gjithë informacionin e depozituar dhe do të diskutojë me ju këto gjetje. McCourt do të japë dy përgjigje ku shprehet për pranimin ose refuzimin e kërkesës, ku e para do të jetë verbale dhe e dyta me shkrim. Nëse kërkesa do të pranohet, McCourt do t'ju paguajë ose rimbursojë drejtpërdrejt ose nëpërmjet një kërkesë sigurimi me anë të Shoqërisë së Sigurimit të McCourt Constructions. Nëse kërkesa do të refuzohet, McCourt do t'ju informojë lidhur me arsyen e refuzimit. Gjithashtu, McCourt do t'ju informojë për hapat e mëtejshëm që mund të ndërmerri.

Nëse nuk jeni të kënaqur me gjetjet e hetimit të McCourt, mund ta depozitoni rastin te shoqëria juaj e sigurimit, e cila do të përpiqet të përcaktojë detyrimin. Nëse siguresi gjykon se McCourt është përgjegjës, kostot do të rimbursohen nga McCourt. Një tjetër mundësi e disponueshme për personat të cilëve u është refuzuar kërkesa është të depozitohen një padi në gjykatën për paditë e vogla. Detyrimi do të rishikohet dhe përcaktohet nga një gjyqtar.

Nëse keni pyetje të tjera në lidhje me procesin e kërkesave, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni, qoftë me linjën tonë telefonike në numrin 833.238.4743, ose me email në adresën info@BeverlyRegionalTransmissionReliabilityProject.com.